



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.3.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve për periudhën 7 – 25 mars
2. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i aktit normativ Nr. 1, datë 9.2.2022 “Për disa ndryshime (amendimi i tretë) në tekstin e marrëveshjes për prodhimin e furnizimin nga dhe ndërmjet Pfizer export b.v., Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ Nr. 3, datë 18.1.2021 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar”.
3. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Europa krijuese (2021-2027)".
4. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurime shoqërore".

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Blerina Gjylameti, Shpresa Marnoj, Enslemvera Zake, Arbi Agalliu, Dashamir Shehi, Edmond Spaho, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Pranvera Resulaj, Anila Denaj dhe Bujar Leskaj.

Mungojnë:

Alfred Rushaj, Jorida Tabaku, Benet Beci, Erion Braçe, Emilja Koliqi dhe Agron Shehaj.

Të ftuar:

Vjollca Braho – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Eugena Tomini – Drejtoreshë e Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrëna – Drejtoreshë juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gentian Opre - Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ina Dhaskali – Përgjegjëse e sektorit të Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Meri Kumbe – Zëvendësministre e Kulturës

Anila Muka - Drejtore e Drejtorisë së Integritetit në Ministrinë e Kulturës

Olta Manjani - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Albin Gega - Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Astrit Hado - Drejtor i Përgjithshëm i ISSH-së

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Para se të fillojmë mbledhjen e sotme të verifikojmë kuorumin, të cilin e kemi bashkë me 4 anëtarë, që po e ndjekin mbledhjen *online*.

Mund ta thërrasim medien.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, doja t'ju njoftoja që kryesia e komisionit parlamentar u mblodh sot në mëngjes për të diskutuar për çështje të ndryshme, një nga të cilat është edhe ngritja e nënkomisionit parlamentar, sikundër jeni në dijeni, me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të UNDP-së dhe bashkë me zonjën Koti, zonjën Gjylameti dhe zonjën Zake kemi rënë dakord për anëtarësinë e komisionit, të cilin do ta kryesojë zonja Denaj, edhe për shkak të angazhimit, ndërkohë që anëtarësia ka si anëtare zonjën Zake, zonjën Koti në cilësinë e nënkryetares, zonjën Resulaj, zotin Agalliu dhe zonjën Koliqi.

Komisioni i mëparshëm ka qenë me 7 anëtarë, edhe komisionin aktual e lamë po me 7 anëtarë. Ndërkohë do të duhet të diskutojmë edhe çështjen një nënkomisioni tjetër, atë të lënë si porosi nga raporti i Komisionit European, që ka lidhje me monitorimin e raporteve të KLSH-së.

Dakord për këtë pikë.

Nga ana tjetër, në rendin e ditës së sotme kemi miratimin e kalendarit të punimeve për periudhën 7 - 25 mars, për të cilin besoj se jemi dakord.

Dakord.

Më pas kemi shqyrtimin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi e aktit normativ nr. 1, datë 09.02.2022 “Për disa ndryshime (amendimi i tretë) në tekstin e marrëveshjes për prodhimin e furnizimin nga/dhe ndërmjet Pfizer export b.v., Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave,” të ndryshuar”.

Ndërkohë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kemi të ftuar zëvendësministren, zonjën Vjollca Braho, drejtoreshën e Shëndetit Publik, zonjën Eugena Tomini, dhe drejtoreshën Juridike, zonjën Antoneta Njehrrëna, të cilave u uroj mirëseardhjen në komision.

Nga Ministria e Financave kemi ftuar zotin Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor, dhe zonjën Ina Dhaskali, përgjegjëse e Sektorit të Programimit Buxhetor. Nuk është? Dakord.

A ka ardhur Gentiani?

Dakord.

Në rendin e ditës kemi edhe dy çështje të tjera, por të vijojmë me çështjen e parë.

T'ua japin fjalën përfaqësuesve të ministrisë, pastaj relatorit, nëse do të ketë pyetje dhe diskutime, përpara se ta kalojmë në miratim.

Fjala për ju.

Vjollca Braho – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij projektakti është miratimi i disa ndryshimeve në marrëveshjen me kompaninë “Pfizer”, e cila do të mundësojë blerjen e dozave të tjera nga kjo kompani. Sikurse e dini ne kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me kompaninë “Pfizer” për blerjen e dozave të prodhuara nga kjo kompani.

Marrëveshja bazë, e miratuar me aktin normativ nr. 3 të vitit 2021, që ju e keni kaluar, edhe sasia e alokuar nëpërmjet amendimit është përlogaritur në bazë të nevojave për vaksinimin e popullatës target për vitin 2022.

Në vijim të njoftimit nga kompania “Pfizer” për disa ndryshime menjëherë Ministria e Shëndetësisë ngriti grupin negociator, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Shtetit për Rindërtimin dhe nga ISSH-ja, të cilat diskutuan së bashku për ndryshimet e propozuara nga kompania “Pfizer” si dhe amendimin e tretë të marrëveshjes bazë.

Gjithashtu, një risi e re në këtë marrëveshje është përcaktimi i vaksinës pediatrike, e cila nënkupton një formë të veçantë të vaksinimit. Kjo do të përfshihet edhe në furnizimin që do të bëhet për vitin 2022, pasi edhe Komiteti Teknik e miratoi javën e kaluar edhe vaksinimin e fëmijëve nën moshën 12 vjeç. Gjithashtu, në këtë marrëveshje është përcaktuar që do të blihen 1 milion doza, shpërndarje e të cilave do të bëhet deri në fund të muajit mars, do të vijnë 300 mijë doza, në fund të muajit qershor 200 mijë doza, në fund të shtatorit 100 mijë doza dhe deri në fund të dhjetorit do të vijnë edhe 300 mijë doza të tjera.

Sigurisht, nëse do të jenë të nevojshme më shumë se 1 milionë doza, siç është e përcaktuar në kontratë, do të bëhet blerje me porosi shtesë detyruese deri në 500 mijë doza, të cilat do të vijnë gjatë 3-mujorit të 4 të vitit 2022 dhe vitit 2023.

Domosdoshmëria për të vaksinuar të gjithë popullatën target mbetet ende një emergjencë.

Për sa i përket situatës epidemiologjike në vend, shohim që kemi një përmirësim në dy javët e fundit, pasi vijon pozitivitet më i ulët në 24 orë, si dhe kemi nivel më të ulët të personave të hospitalizuar. Në këto momente kemi 1531 rastet aktive dhe gjatë javës së fundit janë konfirmuar me COVID-19 78 raste në ditë, duke u krahasuar me një javë më parë kur ishin 147 raste në ditë.

Njëkohësisht, në të dyja spitalet në COVID 1 dhe COVID 2 janë hospitalizuar 46 raste, nga të cilat 7 janë në terapi intensive.

Në lidhje me rastet pozitive, kemi një ulje nga 7,1% në 6,8% ndërsa për sa i përket vaksinimit, ne jemi furnizuar me 3 milionë e 141 mijë e 630 doza vaksinash dhe janë administruar në total brenda territorit të Shqipërisë 2 milionë e 640 mijë e 393 doza. Njëkohësisht janë vaksinuar dhe 119 mijë e 965 shtetas shqiptarë jashtë territorit të Shqipërisë, pra gjithsej në Republikën e Shqipërisë janë vaksinuar 2 milionë e 760 mijë e 358 qytetarë.

Për sa i përket mbulesës së vaksinimit për target-grupin mbi 16 vjeç, paraqitet në 60,7% mbulesë vaksinimi me dozën e parë, 56,6% me mbulesë vaksinimi me të dyja dozat dhe një 11,1% me mbulesë vaksinimi me dozën e tretë.

Që nga fillimi i procesit të vaksinimit e deri sot për sa i përket pjesë së përgjithshme të popullatës, është me një mbulesë vaksinale 4,8% (mbulesa vaksinale e popullsisë me një dozë), 45,5% me dozën e dytë dhe 8,9% me dozën e tretë. Ndërsa grupet e riskut kanë një përqindje mjaft të lartë të vaksinimit në masën 90%.

Kjo është situata në të cilën ndodhemi, sigurisht është në shqyrtimin tuaj dhe nëse keni pyetje, jemi të hapur për t'i pritur pyetjet tuaja.

Ju faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Braho!

Zoti Xhelili.

Alban Xhelili – Faleminderit, zoti kryetar!

Sot jemi mbledhur që të shqyrtojmë aktin normativ, qëllimi i tij është miratimi i disa ndryshimeve në marrëveshje me kompaninë “Pfizer”, të cilat do të mundësojnë blerjen e dozave të vaksinës për periudhën 2022-2023 dhe ne, si Komision i Ekonomisë dhe Financave, e shqyrtojmë këtë në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32 dhe 38 të

Rregullores së Kuvendit. Gjithashtu, një vlerësim lidhur me ligjshmërinë, kushtetutshmërinë dhe harmonizimin e institucionit me legjislacionin në fuqi vendas dhe ndërkombëtar.

Këshilli i Ministrave ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1, dhe nenin 121, pika 1, të Kushtetutës në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe nenin 100 të Kushtetutës, si dhe me nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”

Akti normativ i Këshillit të Ministrave është në përputhje me Kushtetutën, veçanërisht me nenin 101 të saj, ku parashikohet që Këshilli i Ministrave në rast të nevojave dhe urgjencave, në përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit “Për marrjen e masave të përkohshme”.

Akti normativ i dërgohet menjëherë Kuvendit, i cili brenda 5 ditëve, nëse nuk është mbledhur, miratohet. Këto akte e humbasin fuqinë që nga fillimi nëse nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve, nevoja dhe urgjenca janë parakushte të domosdoshme për nxjerrjen e një akti normativ.

Pandemia aktuale, e shkaktuar nga Sars-COV 2, ose Covid-19, ka shkaktuar dëme të mëdha në shëndetin e njerëzve, duke kaluar deri në humbje jete, natyrisht edhe dëme ekonomike, qoftë për buxhetin e personave të prekur, qoftë për buxhetin e bizneseve, për shkak të vendosjes së masave kufizuese të frekuentimit të tyre, qoftë edhe dëme në buxhetin e shtetit, duke kaluar fokusin më të madh në shërbime shëndetësore, kryesisht spitalore. Situata e krijuar nga Sars-COV 2 vlerësohet si e pa mundur për të pritur aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e një ligji të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara. Nevoja për furnizimin me vaksina anti-Covid është imediate, pasi domosdoshmëria për vaksinimin e të gjithë popullatës target mbetet ende një emergjencë. Ky akt normativ i nënshtrohet dërgimit për miratim në Kuvendin e Shqipërisë brenda afatit kushtetues.

Lidhur me qëllimin dhe përmbajtjen, qëllimi i këtij akti normativ është miratimi i disa ndryshimeve në marrëveshjen me kompaninë Pfizer, të cilat do të mundësojnë blerjen e dozave të vaksinës për periudhën 2022-2023.

Amendimet e këtij akti normativ do të përcaktojnë rregullat e zbatueshme të vendosjes së produktit në Shqipëri, që “Pfizer” të veprojë me të gjitha licencat dhe lejet rregullatore qeveritare, si dhe të veprojë në përputhje me të gjitha praktikatat aktuale të prodhimit lidhur me proceset e saj të prodhimit e të paketimit, objekteve apo të tjera, për të lejuar përmbushjen e detyrimeve të saj, sipas këtij ligji.

“Pfizer”-i do të sigurohet që i gjithë produkti të jetë i etiketuar dhe i paketuar, siç duhet, në përputhje me autorizimin, specifikimet dhe standardet e materialeve të praktikave aktuale të prodhimit në fuqi.

Amendimet në këtë akt ligjor parashikojnë modalitetet që zbatohen në rast se Shqipëria dëshiron të dhurojë doza kundrejt vendeve të treta. Për këtë të fundit parashikohet se në rastet kur dozat e kontraktuara të furnizuara nga “Pfizer”-i për blerësin përbëjnë një tepricë të furnizimit për kërkesat e blerësit dhe kanë jetëgjatësi të përshtatshme për këto doza të tepërta. Blerësi mundet që, në varësi të kushteve, të bëjë një donacion në një vend ose institucion publik, për shembull Covax *Facility* për produktet që i kalojnë 5% të dozave të kontraktuara.

Në vijim të njoftimit “Pfizer” për ndryshimet e lartpërmendura me urdhër nr. 42, datë 20.01.2022 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ngritjen e grupit negociator për vlerësimin e kushteve të ndryshimit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet Pfizer export b.v. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Shtetit për Rindërtim dhe ISSH-në, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u ngrit grupi negociator për vlerësimin e kushteve të ndryshimit të marrëveshjes me specialistë të fushave të ndryshme, i cili diskutoi për ndryshimet e propozuara nga Pfizer export b.v, si amendamenti i tretë i marrëveshjes bazë. Akti normativ përmban parashikimet e mëposhtme:

Në nenin 1 parashikohet miratimi i tekstit të disa ndryshimeve (amendimi i tretë), parashikon ndryshimet e organeve shtetërore dhe hyrjen në fuqi.

Ky akt normativ shoqërohet me efekte financiare, që do të mbulohen nga buxheti i alokuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për furnizimin me vaksina për vitin 2022. Lidhur me institucionet zbatuese, institucioni përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij akti normativ janë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtim dhe programin e reformave.

Kaq kisha.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Xhelili!

A ka pyetje, ose diskutime nga kolegët? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Pranvera, kishit diçka?

Po, shpejt!

Pranvera Resulaj – Meqenëse nuk e kisha diskutim, thjesht dua të përfitoj nga rasti që kam përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë këtu që të nxisim sa më shumë të jetë e mundur vaksinimin masiv, sepse praktikisht e kemi parë efekti që ka në popullatë është shumë pozitiv dhe ndoshta kjo do ta sillte njëherë e mirë përfundimin e kësaj situatë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Resulaj!

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, duke falënderuar përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë para se të largohen kam një kërkesë, shërbimet e Kuvendit do ta mbajnë shënim, e kam diskutuar edhe me ministren, në lidhje me një VKM për duhanin, që është pezull prej një kohe shumë të gjatë. Thjesht mbajeni shënim se si do të procedohet, por po pengon aplikimin e ligjit. Detajet do t'i japin shërbimet e Kuvendit.

Gjithsesi, ju falënderoj dhe ju uroj punë të mbarë!

Meqenëse zonjën Tomini e kemi për herë të parë me statusin e drejtoreshës së Shëndetit Publik, ajo ka qenë zëvendësministre shumë e pranishme në kohën e pandemisë me shpjegime dhe me analiza, doja t'i uroja kthim të mbarë aty ku ka nisur karrierën e saj! Është një sinjal i mirë.

Ndërkohë, edhe zëvendësministres së re, zonjës Braho, i uroj suksese!

Ditën e mirë!

Eduard Shalsi – Faleminderit për shpjegimet!

Sekretare e komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar Administrariv
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më 07.03.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Europa krijuese” (2021-2027)”.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Blerina Gjylameti, Shpresa Marnoj, Enslemvera Zake, Arbi Agalliu, Dashamir Shehi, Edmond Spaho, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Pranvera Resulaj, Anila Denaj dhe Bujar Leskaj.

Mungojnë:

Alfred Rushaj, Jorida Tabaku, Benet Beci, Erion Braçe, Emilja Koliqi dhe Agron Shehaj.

Të ftuar:

Olta Manjani – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Albin Gega – Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Astrit Hado – Drejtor i Përgjithshëm i ISSH-së

Eduard Shalsi – Kalojmë te çështja e dytë e rendit të ditës: shqyrtimi, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Europa krijuese” (2021-2027)”. Ndërkohë, relatores kemi zonjën Pranvera Resulaj.

Çështja tjetër e rendit të ditës është shqyrtimi, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore”.

Atëherë, kemi përfaqësuesit e ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, kalojmë te çështja e tretë e rendit të ditës me Ministrinë e Financave?

(Diskutime pa mikrofon.)

Vijojmë me çështjen dytë të rendit të ditës. Të ftuar kemi nga Ministria e Kulturës, zëvendësministren e Kulturës zonjë Meri Kumba, apo jo?

(Diskutime pa mikrofon.)

Edhe një herë, kemi çështjen e katërt të rendit të ditës, të nderuar kolegë, shqyrtimin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore”.

Të ftuar kemi zonjën Manjani, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, zotin Albin Gega, drejtor i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësive Profesionale, si dhe zotin Astrit Hado, drejtor i Përgjithshëm i ISSH-së.

Relatores kemi zonjën Shpresa Marnoj.

Pa humbur kohë po ia kalojmë fjalën përfaqësuesve të ministrisë dhe më pas relatores. Nëse kolegët do të kenë pyetje, do të vijojmë me pyetje për ta përmbyllur me diskutime.

Atëherë, fjala për përfaqësuesit e ministrisë.

Olta Manjani – Mirëmëngjesi edhe një herë të gjithëve!

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Propozimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore” është në respektim dhe në përmbushje të procedurave ligjore të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje kuadër, e nënshkruar ndërmjet dy vendeve tona në datën 26 nëntor 2021, pjesë e procesit të koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e iniciuar në përputhje me eksperiencën më të mirë ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shoqërore është konfirmim i vullnetit dhe i angazhimit për thellimin e bashkëpunimit dhe çuarjen përpara të marrëveshjeve të shkëlqyera që ekzistojnë midis dy vendeve tona. Në këtë frymë është finalizuar edhe procesi i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje kuadër, e cila ka nisur që në vitin 2020 dhe për hyrjen në fuqi dhe zbatimin efektiv të saj kërkon ratifikimin respektiv nga kuvendet e të dyja vendeve tona. Marrëveshja konsiston në ofrimin e përfitimeve në sigurimet shoqërore dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të punëtorëve përmes mundësimit të shtetasit i të njëjtave të drejta dhe detyrime lidhur me mbrojtjen shoqërore me ato të shtetasve vendas.

Pjesë të parimeve kryesore të kësaj marrëveshjeje janë: parimi i ruajtjes së të drejtave të arritura, ku parashikohet që periudha e sigurimit të realizuar nga një shtet të njihet edhe nga shteti tjetër, me kushtin e vetëm që ato të mos mbivendosen dhe me parimin e eksportimit të përfitimeve, e cila nënkupton të drejtën e çdo personi për të tërhequr përfitimin e siguruar, pavarësisht nga vendndodhja e tij. Gjithashtu, marrëveshja garanton që personat, që lëvizin nga një vend në tjetrin, të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar dhe, njëkohësisht, asnjë qytetar nuk do t'i humbasë asnjë ditë kontribut, pavarësisht se në cilin vend ka punuar, për faktin e vetëm se bashkimi i periudhave bën të mundur plotësimin e kushteve ligjore për përfitimin e pensionit në të dyja vendet tona.

Objekt i kësaj marrëveshjeje janë përfitimet respektive nga skemat e sigurimeve shoqërore të të dyja vendeve, ku përkatësisht nga skema shqiptare e detyrueshme e sigurimeve shoqërore përfshihen: përfitimet në para për barrëlindje për personat e punësuar, personat e vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit; përfitimet në para për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për personat e punësuar; për pensionin e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit.

Nga skema kosovare e sigurimeve shoqërore përfshihen: e drejta në pension kontributpagues të moshës; e drejta në pension të invaliditetit të punës; e drejta në pension familjar; e drejta në pension nga fondi i kursimeve të pensioneve individuale (shtylla e dytë).

Referuar të dhënave zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, shtetas të pajisur me vërtetim deklarimi për punësim për periudhën janar-dhjetor 2020 janë 116 shtetas kosovarë dhe për periudhën janar-dhjetor për vitin 2021 janë 161 shtetas kosovarë, të cilët janë kryesisht të punësuar në fushën e industrisë përpunuese në prodhim brumërash, si dhe në sektorin bankar. Ndërsa, referuar të dhënave zyrtare të INSTAT-it, në vitin 2020 kanë aplikuar

për leje qëndrimi 916 shtetas kosovarë. Referuar të dhënave zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, me leje qëndrimi të përkohshëm për arsye pune për periudhën janar-dhjetor 2020 janë pajisur 454 shtetas shqiptarë dhe për periudhën janar –dhjetor 2021 janë pajisur 543 shtetas shqiptarë.

Zbatimi i marrëveshjes nuk do të ketë efekt financiar të menjëhershëm, pasi e drejta për përfitime nga skemat e sigurimeve shoqërore shtetasve shqiptarë u lind në një periudhë të dytë, kur ata të kenë mbushur moshën për pension.

Efektet financiare janë në ngarkim të fondit buxhetor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe financohen nga kontributet. Marrëveshja parashikon dhënie përfitimi vetëm për kontributet e paguara.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Manjani!

Fjala për relatoren zonja Marnoj.

Shpresa Marnoj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, Zëvendësministre!

Sot shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore”. Ky komision e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Në dispozitat e kësaj marrëveshjeje dypalëshe reflektohen të gjitha rregullat për koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar, personat e vetëpunësuar dhe për punëdhënësit, të cilat janë përcaktuar në rregulloren e Këshillit nr. 1408/71 dhe rregulloren nr. 883/2004 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit Europian.

Dispozitat e marrëveshjes harmonizojnë, gjithashtu, legjislacionet kombëtare të të dyja vendeve për përfitimet, që kanë të bëjnë me sëmundjet, barrëlindjet, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore. Dispozitat e propozuara respektojnë Kushtetutën dhe parimet e saj.

Qëllimi i këtij projektligji synon ratifikimin nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore. Marrëveshja është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 719, datë 24.11.2021. Kjo marrëveshje është në përputhje me eksperiencën

ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes shoqërore, ku mbrojtja e emigrantëve rregullohet nëpërmjet aderimit në instrumentet ligjore ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes shoqërore, nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve respektive, si dhe nga legjislacioni kombëtar. Në kuadër të lëvizjes së lirë të personave, ekzistojnë rregullat për koordinimin e sistemeve kombëtare të mbrojtjes shoqërore, të cilat kontribuojnë në drejtim të përmirësimit të standardit të jetesës dhe kushteve të punësimit për këta persona. Kjo marrëveshje do të krijojë mundësinë e përfitimit të pensioneve nga shqiptarët, që jetojnë e punojnë në Kosovë, si dhe për shtetasit kosovarë të cilët vijnë për të punuar në Shqipëri.

Objekt i kësaj marrëveshje janë përfitimet nga skema shqiptare e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, të cilat përfshijnë: përfitimet në para për barrëlindje për personat e punësuar, personat e vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit; përfitimet në para për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për personat e punësuar; për pensionin e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit.

Në pjesët që ka kjo marrëveshje, përcaktohen disa përkufizime, të cilat unë vetëm po i përmend si pika për të mos u zgjatur, ku përcaktohen përkufizimet për legjislacionin, autoritetet dhe agjencitë kompetente të të dyja vendeve, fushëveprimi personal; përcaktohen dispozita në lidhje me legjislacionin e zbatueshëm të të dyja vendeve dhe rregullime të veçanta; përcaktohet bashkimi i periudhave të sigurimit për përfitim pleqërie, familjar apo invaliditeti, me kusht që ato të mos mbivendosen; përcaktohen dispozitat e veçanta lidhur me 3 përfitimet në Republikën e Shqipërisë, si dhe dispozitat e veçanta për Republikën e Kosovës; përcaktohen dispozitat e përbashkëta të përfitimeve në të dyja shtetet; përfshihen dispozita të ndryshme administrative lidhur me përgjegjësitë e autoriteteve kompetente; përcaktohen dispozitat kalimtare dhe përfundimtare në lidhje me rastet para hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Kjo besoj se është një marrëveshje e shumëpritur për shtetasit shqiptarë që punojnë në Kosovë dhe shtetasit kosovarë që punojnë në Shqipëri, sepse në aspektin e mbrojtjes sociale kjo duhet të jetë gjëja më normale, e cila mund të pretendohet, pra njohja e kontributeve, për të cilat ata kanë punuar gjatë jetës së tyre.

Gjithashtu, Shqipëria në fushën e sigurimeve ka marrëveshje edhe me Republikën e Turqisë, Belgjikës, Hungarisë, Rumanisë, Maqedonisë së Veriut, Çekisë, Gjermanisë, Austrisë, Luksemburgut dhe Kanadasë.

Efektet financiare nuk janë të matshme, sepse maturimi i saj është afatgjatë. Nuk do të ketë efekt financiar të menjëhershëm, pasi e drejta për përfitime nga skema e sigurimeve

shoqërore shtetasve shqiptarë u lind në një periudhë të dytë, kur ata të kenë mbushur moshën për pension.

Sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të gjithë këta persona do të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore e kontributeve shqiptare, nëse do të kenë 15 e më shumë vjet pune të siguruara. Efektet financiare janë në ngarkim të Fondit të Sigurimeve Shoqërore. Marrëveshja parashikon dhënie përfitimi, vetëm për kontributet e paguara. Ftoj kolegët që ta miratojnë këtë projektligj.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Marnoj!

A ka pyetje?

Po zoti Shehi dhe më pas zonja Marnoj dhe zonja Dhima.

Meqenëse jeni relatore mund të filloni e para.

Shpresa Marnoj – Pikërisht nga këta hapa, të cilat ishin pjesë e marrëveshjes, në pjesën e tretë të kapitullit 2, ku përcaktohet bashkimi i periudhave të sigurimit për përfitim pleqërie, familjar apo invaliditeti, me kusht që ato të mos mbivendosen... Unë këtë nuk e kuptoj shumë mirë. Përderisa këto kontribute, kur të llogaritet pensioni, pra kur të mblidhen vitet e punës këtu dhe vitet e punës në Kosovë, çfarë kuptimi ka kjo “mbivendosje”?

Faleminderit!

Astrit Hado – Faleminderit për pyetjen!

Atëherë, parimi kryesor i kësaj marrëveshjeje është që, nëpërmjet bashkimit të periudhave të sigurimit, të arrihet të plotësohen kriteret ligjore në të dyja vendet, që do të thotë se Shqipëria e ka kriterin minimal të periudhës së sigurimit 15 vjet. Kjo do të thotë që çdo i siguruar, që ka më pak se 15 vjet, nuk llogaritet për asnjë lloj pensioni në Shqipëri. Bashkimi i këtyre periudhave të kontributeve të realizuara edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë, plotëson kushtin ligjor prej 15 vjetësh, që hyn në skemën e sigurimeve shoqërore, dhe pensioni llogaritet vetëm në bazë të viteve që ka të siguruara në Shqipëri dhe anasjelltas për shtetasit kosovarë në Kosovë. Ka raste që, për shkak të skemës së sigurimit vullnetar që ne kemi në Shqipëri, një qytetar shqiptar mund të jetë i siguruar si qytetar në Kosovë, por, njëkohësisht, bën edhe sigurimin vullnetar në Shqipëri për të njëjtën periudhë kohore për vitin 2021, atëherë merret vetëm një vit. Pra, për një vit kalendarik quhet vetëm një vit sigurimi, nuk mund të quhen dy vjet, ndaj është vendosur ai përkufizim në atë nen të marrëveshjes, që, në rast se ka mbivendosje të periudhave të sigurimit, secili shtet do të zgjedhë periudhën e tij të sigurimit.

Eduard Shalsi – Po, zoti Shehi.

Më pas zonja Dhima.

Dashamir Shehi – Si fillim, është bërë mirë që është mbyllur kjo historia qoftë me Kosovën, qoftë edhe me disa vende të tjera. Unë mendoj se kjo marrëveshje me Kosovën nga ana financiare nuk është se ka ndonjë efekt të madh financiar, sepse do të ndihet në vitet që do të vijnë. Unë dua të bëj një pyetje, se këtu kam dëgjuar disa herë që është bërë një marrëveshje me Italinë. A është bërë kjo realisht, apo është thjesht një legjendë? Dua të di: çfarë është shkruar, çfarë është nënshkruar, si do t'u përgjigjemi njerëzve, se nuk na rezulton kurrkund kjo? U tha një herë, u bë një zhurmë e madhe dhe ka gati 2 muaj, në mos gaboj, por a ka ndonjë draftmarrëveshje me Italinë? A është bërë në nivel ministrish, apo e ka bërë instituti ynë me IMS-in në Itali? Si e keni bërë këtë marrëveshje dhe, në qoftë se është bërë, kur hyn në fuqi dhe çfarë kushtesh keni vënë? E fundit, që është më e rëndësishmja: a keni parashikuar fond për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, sepse jam i sigurt që do të sjellë menjëherë disa shpenzime, se janë 200 mijë shqiptarë në treg të punës në Itali, se nuk është problem me Kosovën për 100 apo 150 veta? E fundit, me Greqinë apo negociohet për këtë punë? Kaq kisha.

Olta Manjani – Atëherë, në lidhje me pyetjen e parë, patjetër që ne aktualisht kemi filluar negociatat, ku është ngritur grupi i punës dhe shumë shpejt do të fillojmë negociatat me Italinë për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Kjo është ...

Dashamir Shehi – Deri tani gjë zyrtare nuk ka?

Olta Manjani – Deri tani kemi pasur kontakte me palën italiane dhe kemi rënë dakord që negociatat do të fillojnë shumë shpejt. Aktualisht nuk ka një draftmarrëveshje, por, sigurisht, grupi i punës në vijim do të merret me hartimin e draftmarrëveshjes së bashku me palën italiane.

Për t'u përgjigjur pyetjes së dytë, që ka lidhje me Italinë, gjithashtu, grupi i punës patjetër që do të bëjë edhe një llogaritje dhe një vlerësim të efekteve financiare që do të ketë kjo marrëveshje pasi, siç dihet, është një numër i lartë shqiptarësh, që jetojnë dhe punojnë në Itali dhe anasjelltas një numër i lartë shtetasish italianë, të cilët jetojnë dhe punojnë në Shqipëri. Aktualisht nuk ka një vlerësim të tillë, por patjetër që grupi i punës do të merret me këtë çështje në vijim.

Ndërkohë, lidhur me pyetjen që kishit për Greqinë, patjetër që pala shqiptare ka këmbëngulur dhe ka insistuar disa herë që të ketë një marrëveshje me shtetin grek, megjithatë nga ana e palës greke nuk ka pasur një qasje të tillë, nuk ka një dakordësi nga ana e tyre për të filluar negociatat për një marrëveshje të tillë në fushën e sigurimeve shoqërore. Pra, nuk ka një

vullnet politik nga ana e Greqisë, edhe pse është këmbëngulur disa herë nga pala shqiptare, për të nënshkruar një marrëveshje të tillë.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Mund të them diçka unë për Italinë, në fakt, se vetëm disa ditë më parë kam pasur një takim në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Ekonominë, që, nëse deri dje ka qenë një dëshirë dhe vullnet, muajt dhe sidomos javët e fundit, madje Kryeministri ka dhe një takim zyrtar këto ditë, kemi një hap cilësor dhe çështja tashmë është duke u diskutuar pranë institucioneve italiane, me të cilat parimisht është rënë dakord. Pra, ndryshe nga herët e tjera, ku kanë qenë diskutime, në parim është rënë dakord dhe pritet vetëm të fillojë dhe të detajohen çështjet.

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja zëvendësministre, për prezantimin e kësaj marrëveshjeje!

Në fjalën tuaj ju theksuat se ka shumë raste të punësimit të qytetarëve shqiptarë në Kosovë dhe njëkohësisht të qytetarëve nga Kosova në Shqipëri.

Pyetja ime është: sa mendohet se do të jetë numri i personave, të cilët do të jenë përfitues sipas kësaj aktmarrëveshjeje, duke pasur parasysh objektin, si dhe kategoritë të cilat përfitojnë?

Në vijim dhe të fjalës së zotit Shehi, faktikisht e vlerësoj këtë marrëveshje dhe çdo lloj marrëveshjeje tjetër që u vjen në ndihmë emigrantëve, të cilët punojnë dhe jetojnë jo vetëm në Kosovë, por dhe në të gjitha vendet e tjera.

Faleminderit!

Olta Manjani –Faleminderit për pyetjen!

Sigurisht që kjo do të varet edhe nga zhvillimet në tregun e punës, pra sa shtetas kosovar hyjnë dhe punojnë në territorin e Shqipërisë dhe anasjelltas, sa shtetas shqiptarë hyjnë dhe punojnë në territorin e Kosovës. Për momentin nuk ka një shifër, sepse këto janë shifra që netohen, pra hyrjet dhe daljet e shtetaseve brenda dhe jashtë kufirit. Gjithsesi, do të ngelet për t'u vlerësuar në një moment të dytë, kur këto marrëveshje të hyjnë në fuqi, në përmbushjen e kriterit të moshës së pensionit.

Eduard Shalsi – Në rregull?

A ka pyetje apo diskutime nga kolegët e tjerë? Nuk ka.

Atëherë, duke i falënderuar përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe duke i përgëzuar për këtë marrëveshje, kalojmë në votim!

Kjo marrëveshje ka 2 nene.

Kush është pro në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju përgëzojmë për punën dhe ju urojmë mbarësi!

Sekretare e komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar Administrariv
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.3.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Europa Krijuese (2021-2027)”

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Blerina Gjylameti, Shpresa Marnoj, Enslemvera Zake, Arbi Agalliu, Dashamir Shehi, Edmond Spaho, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Pranvera Resulaj, Anila Denaj dhe Bujar Leskaj.

Mungojnë:

Alfred Rushaj, Jorida Tabaku, Benet Beci, Erion Braçe, Emilja Koliqi dhe Agron Shehaj.

Të ftuar:

Meri Kumbe - Zëvendësministre e Kulturës

Anila Muka - Drejtore e Drejtorisë së Integritimit

Eduard Shalsi – Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, meqenëse patëm një kapërcim. Të ftuara janë përfaqësueset e Ministrisë së Kulturës, zonja Meri Kumbe dhe drejtorja e Drejtorisë së Integritimit, zonja Anila Muka, të cilave u uroj mirëseardhjen në komision!

Do të vijojmë me një prezantim nga zonja Kumbe dhe më pas me relatorin, do të vijojmë me pyetjet dhe diskutimet.

Zonja Kumbe, fjala për ju.

Meri Kumbe – Përshëndetje!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Europa Krijuese (2021-2027)” mbështetet në nenet 78 dhe 83, pikat 1 dhe 2, si dhe në nenin 121 të Kushtetutës, është në përputhje me ligjin nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Komitetit Europian dhe shteteve anëtare të tyre, ratifikuar me ligjin nr.9590, datë 27.10.2006.

Në këtë kuadër, Shqipëria ka marrë angazhimin për të qenë pjesë e këtij programi, duke nënshkruar në datën 7 dhjetor të vitit 2021 marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Europa Krijuese. Këshilli i Ministrave, në datën 9 shkurt 2022 ka miratuar projektvendimin për propozimin e këtij projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Europa Krijuese është programi kryesor i Komisionit Europian për të mbështetur sektorin e kulturës dhe atë audioviziv. Programi u miratua në Parlamentin Europian fillimisht më 19 nëntor të vitit 2013 dhe u miratua nga Këshilli Europian më 3 dhjetor të vitit 2013. Ai mori jetë për herë të parë në janar të vitit 2014. Në nëntor të vitit 2020 u rinovua edhe për 7 vjet të tjerë, pra nga viti 2021 deri në vitin 2027. Pritet që nga ky program i Europës Krijuese të mbështeten rreth 250 mijë artistë në tërësi; është tejet i rëndësishëm për shtetin shqiptar dhe për artistët shqiptarë dhe jo vetëm për sa i përket mundësisë që i krijojnë në tregun europian rritjes së kapaciteteve për aktivitetet kulturore, si dhe rritjes së kapaciteteve të trajnimit të burimeve njerëzore për projektet që marrin pjesë në këtë kuadër.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjala për relatoren, zonjën Resulaj.

Pranvera Resulaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, e nderuar zëvendësministre!

Në fakt, ashtu sikundër e thatë, projektligji vjen si një ratifikim i një marrëveshjeje për t'u mundësuar të gjithë artistëve të rinj të jenë pjesë e mbështetjes financiare nga Bashkimi European. Kjo është një ndihmesë e madhe, por nuk do të ndalem këtu. Kjo do të shërbejë edhe për të mundësuar shkëmbimin kulturor ndërmjet vendeve brenda Bashkimit European.

Për sa kohë Komisioni për Ekonominë dhe Financat është një komision për dhënie mendimi dhe kuptohet që pjesa më e rëndësishme për ne këtu do të mbetet gjithmonë efekti financiar, do t'i kaloj qëllimet dhe objektivat e projektligjit, të cilat ndoshta më së shumti do të jenë objekt i komisionit përgjegjës dhe do të mundohem të shpjegoj në mënyrë pak më të thjeshtë se në projektligj efektin financiar.

Në fakt, kjo marrëveshje nuk është si marrëveshjet e tjera kuadër, të cilat mund të kenë një kuotë anëtarësimi fikse vjetore, për ta kuptuar më së shumti publiku, por është e ndarë në një koncept të efektit financiar në dy drejtime: kontributi operacional dhe tarifa e pjesëmarrjes.

Tarifa e pjesëmarrjes nuk është fikse, por është e bazuar në kontributin fillestar operacional, pra, le të themi, në kontributin e vitit të parë dhe mandej e rregulluar me koeficientin e pjesëmarrjes, që shkon deri në 4%, por e ndryshuar vit pas viti: në vitin e parë 0,5%, 1% në vitin e dytë, 1,5% dhe deri në 2027-n, sikundër e parashikon dhe marrëveshja, shkon 4%. Kjo është pjesa e parë, që është tarifa e pjesëmarrjes.

Drejtimi i dytë shumë i rëndësishëm është kontributi operacional që ka Shqipëria brenda kuadrit të unionit. Pra, duhet të themi që të gjitha projektet e artistëve, në mos gaboj, janë parashikuar rreth 250 mijë artistë për të përfituar nga projektet e unionit, do të mbulohen nga unioni, por Shqipëria do të ketë pjesën e vet të shpenzimeve ose të kontributit financiar.

Kontributi operacional është i rregulluar me një element, që e quajmë çelësi i koeficientit ose koeficienti kyç. Kjo do të përcaktojë se cila do të jetë shuma e pjesëmarrjes së Shqipërisë, e cila do të bëhet e ditur nga unioni. Pjesëmarrja e Shqipërisë, nëpërmjet çelësit kontribut, është e llogaritur në raportin e GDP-së së Shqipërisë me çmimet dhe ndaj GDP-së së Europës, të unionit, herë çmimet. Pra, ky është, si të thuash, një lloj raporti për të treguar peshën specifike që do të ketë kontributi financiar i Shqipërisë në varësi të mundësive që ka ajo, referuar produktit të brendshëm bruto, gjithmonë, në vitin paraardhës, të matshëm, referuar vitit të aplikimit. Pra, në qoftë se aplikohet në vitin 2023, kjo llogaritje do të jetë për vitin paraardhës, kur statistikisht e kemi gati informacionin e këtij viti. Nëse nuk e kemi statistikisht informacionin, do t'i referohemi vitit paraardhës, pra 2022-shit ose 2021-shit, nëse nuk është ky informacion. Me sa kuptoj, 2021-shi i është referuar 2019-s. Pra, kontributi financiar do të matet

në bazë të peshës specifike që ka Shqipëria në raport me produktin e saj të brendshëm bruto. Me sa kam kuptuar, ky koeficient kyç indeksohet, po përdor këtë fjalë, por ndoshta nuk është e duhura, ju mund të na i shpjegoni më qartë, edhe me një koeficient tjetër, i cili është llogaritur të jetë 0,55.

Unë kuptoj që (ndoshta e kam dhe gabim) ky koeficienti 0,5 pikërisht indeksin ose kursin e këmbimit, ose inflacionin. Do ta quaja edhe si një pyetje këtë, për ta saktësuar më tej.

Kjo është për sa i përket efektit financiar, që do të duhet të mbulojë Shqipëria dhe, sikurse e thashë edhe pak më parë, unioni do t'ia bëjë të ditur Shqipërisë në momentin para aplikimit. Duhet ta theksojë që tarifa e pjesëmarrjes duhet të paguhet të paktën 45 ditë pasi ka nisur edhe thirrja për aplikime. Pra, në çdo rast është unioni ai që do të përcaktojë se cilat do të jenë kontributet financiare të shteteve pjesëmarrëse, në rastin tonë të Shqipërisë. Sigurisht që kjo llogaritje bëhet në bazë të këtyre koeficienteve, pra koeficientit kyç shumë të rëndësishëm, sikundër e shpjegova dhe shpresoj të kem qenë e qartë, nëse jo, ndoshta përfaqësuesit e ministrisë mund ta saktësojnë edhe më mirë për publikun. Është në mbështetje të të gjithë artistëve të rinj kryesisht dhe vjen me kontributin financiar të Shqipërisë, të përcaktuar sipas kriterëve të vendosura nga unioni brenda marrëveshjes.

I ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë, sepse, mbi të gjitha, është një mbështetje për artin dhe shkëmbimet kulturore ndërmjet vendeve brenda unionit European.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Resulaj!

Në fakt, e përmendët, por pak më thjesht, për ata që na dëgjojnë, do të doja të dija prej përfaqësuesve të ministrisë se çfarë është Europa Krijuese dhe, së dyti, për kontributin financiar të Shqipërisë. Ka disa përqindje.

Edhe një herë, sa më thjesht këtë çështje.

Kam përshtypjen se relatorja kishte nevojë dhe për disa shpjegime të mëtejshme, të cilave u bashkohem. Nëse ka ndonjë koleg që do të shtojë diçka në lidhje me këtë, përpos pyetjeve të tjera...

Fjala për ju.

Meri Kumba – E thënë me fjalë shumë të thjeshta, Europa Krijuese është thirrja që Bashkimi European hap për të gjithë sektorin e artit dhe medias audiovizuale; është një mundësi ku të gjithë artistët pa përjashtim, nëpërmjet OJF-ve respektive mund të shkojnë dhe të aplikojnë me projekt idenë e tyre për të përthithur financat e nevojitura në mënyrë që projekti i tyre të

marrë jetë. Ajo parashikon tri fusha kryesore: Europa Krijuese Kultura, Europa Kreative Media dhe Europa Krijuese Ndërsektoriale. Para se të futem te risia, më lejoni të përmend shumë shkurt fushat që mbledh. Nis që me trashëgiminë kulturore, të gjitha hapësirat artistike qofshin këto të muzikës, arteve pamore, festivalet, arkitekturë, letërsi, botim, arte skenike dhe inovacion artistik, pra të gjitha ato që në i përmbledhim në termin “industri krijuese”.

Sivjet, për herë të parë ky program ka një risi, që i referohet dhe medias, për sa i përket cilësisë së dhënies së lajmit, transmetimit të tij, pra do të ketë një hapësirë të dedikuar në thirrje, që do të jetë për këtë kategori. Gjithashtu, ndryshe nga projekti i 7-vjeçarit të kaluar, sivjet i jepet mundësia secilit shtet përfitues të aplikojë dhe vetëm. Deri vjet një OJF duhet të ishte në partneritet me dy ose më shumë shtete të Bashkimit Europian për të qenë pjesë e këtij projekti, sivjet secili shtet, pra çdo OJF mund të aplikojë dhe e vetme për të përthithur fondet që do të ketë nevojë.

Eduard Shalsi – Në projektin e mëparshëm...

Meri Kumbe- Jo, sivjet.

Eduard Shalsi - ...a kishte Shqipëria NGO përfituese? Pra, a ka marrë pjesë Shqipëria? Ato aplikonin direkt?

Meri Kumbe – Po, kanë aplikuar direkt, në partneritet me shtete të tjera. Kjo është diferenca ndërmjet thirrjes së kaluar dhe thirrjes së re.

Eduard Shalsi – Tani legjitimohet të aplikojnë pa pasur nevojën për një partneriteti me shtetet...

Meri Kumbe – Për bashkëpunëtorë të huaj.

Madje, për të qenë transparentë dhe korrektë, Shqipëria ka përthithur në total 1 milion e 899 mijë e 414 euro.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Meri Kumbe – Për sa i përket kontributit të shtetit shqiptar për të qenë pjesëmarrës në një projekt të tillë, për të përthithur para, pa dyshim që secili shtet jep pjesën që i takon në formën e një *fi*-je, pra të një tarife hyrëse, le të themi, që do të mundësojë në vazhde benefitin që do të kenë OJF-të për të përthithur fonde. Kjo tarifë është në vlerën 4% dhe është e kalkuluar nga Bashkimi Europian, pra neve na vjen nga komisioni, me përqindjen që i keni dhe në relacion, konkretisht: viti 2021 0,5%; viti 2022 1%; viti 2023 1,5%; viti 2024 2%; viti 2025 2,5%; viti 2026 3% dhe viti 2027 4%. Pse është e tillë? Është progresive dhe është e pamundur të kalkulohet 100% vlera, sepse ndryshon në bazë të sasisë së vlerës që do të japë Bashkimi

European. Pra, nëse sivjet, po themi, ka një grand 1 milion euro dhe vitin tjetër do të japë një grand edhe më të madh, përqindja respektive e shteteve të anëtarësuara në këtë program rritet respektivisht me këtë përqindje. Kalkulimi i kontributit, i tarifës së secilit shtet, i cili jep në këtë program, kalkulohet me PBA-në tonë dhe, gjithashtu, në një formulë komplekse sa u përket përmasave të vendit dhe numrit të popullatës. Pra, është një formulë komplekse, e cila nuk kalon fare nga ne, vjen e diktuar nga ata, si pjesë e marrëveshjes. Faleminderit!

Eduard Shalsi - Kam përshtypjen se zonja Dhima kishte një pyetje. Dakord, nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U kuptua.

A ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin e marrëveshjes. Kush është pro në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Para se të mbyllim mbledhjen, ju njoftojmë se nesër kemi diskutimin për ligjin e *startup*-eve, do të jetë diskutimi final, para se të kalojmë në seancë plenare ditën e enjte.

Nëse kolegët kanë ndonjë kërkesë në lidhje me ligjin e *startup*-eve, tani ose më vonë janë të lutur ta deponojnë pranë shërbimeve të Kuvendit.

Rishihemi nesër në orën 11:00!

Deri atëherë, mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare e komisionit
Enslmvera Zake

Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar Administrariv
Elvi Prifti